



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë,
 - Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
 - Kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të datës 22 nëntor 2011,
- në seancën e mbajtur më 20 dhjetor 2011 nxori këtë:**

VENDIM

I lejohet KOSTT SH.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të **Kodit të Rrjetit** dhe **Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit** si në Shtojcë të këtij vendimi.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 22 nëntor 2011 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Sistemit të Transmisionit, ZRrE ka parë të arsyeshme që të lejojë derogimin në zbatimin dispozitave të neneve të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit si dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Derrogimet e lejuara.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Enver Halimi, Anëtar